LIGJ
Nr.9637, datë 6.11.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8618, DATË 14.6.2000 "PËR TELEKOMUNIKACIONET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 "Përkufizime" bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 9 hiqet fjala "ose".

2. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1 me këtë përmbajtje:

"9/1. Ofrues i shërbimit të telekomunikacioneve është subjekti, të cilit i është dhënë licencë për të ofruar shërbime publike telekomunikacionesh, duke siguruar akses në një operator publik telekomunikacioni.".

3. Pika 28 ndryshohet si më poshtë:

"28. Shërbimi publik telefonik është një shërbim i vlefshëm për publikun për origjinimin dhe marrjen e thirrjeve kombëtare e ndërkombëtare dhe vijimin e thirrjeve drejt shërbimeve të emergjencës nga një numër ose numrat e një plani kombëtar ose ndërkombëtar numeracioni.".

Neni 2

Në nenin 48 bëhen këto shtesa:

1. Në klasën II, rreshti i parë, pas fjalës "rurale" shtohen fjalët "urbane dhe ndërurbane".

2. Në rreshtin e tretë të paragrafit të parafundit, pas fjalës "të parapaguar" shtohen fjalët "ofruesit e shërbimit të telekomunikacioneve".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5123, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu